



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.06.2022

**MBLEDHJA Nr. 27,
Datë 17.06.2022, ora 10:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 17.06.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 27 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 10.06.2022 dhe datë 13.06.2022
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me nr. 372, seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “PPC Albania” sh.a. për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017
5. Mbi licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**